



## ANATOMI

Studentët, mësuesit e ardhshëm të edukimit fizik, u bie që të ndjekin zhvillimin harmonik dhe rritjen natyrore të adoleshentëve.

Për këtë arsye ata duhet të zotërojnë disa njohuri shkencore themelore mbi veprimtarinë muskulare, mbi anët mekanike dhe nervore të saj. Ata duhet të dinë të vlerësojnë shkallën e zhvillimit dhe dëmtimet e mundshme të muskujve, kockave dhe ligamenteve. Duhet të njohin mekanizmin e qarkullimit të gjakut, frymëmarrjes si dhe proceset e metabolizmit.

Pedagogu duhet të jetë i aftë të përcaktojë lëvizjet, cilët janë muskujt e interesuar, në ç'mënyrë e kryejnë lëvizjen dhe cili është rezultati.

Për të gjitha këto arsye, është e domosdoshme të njihet anatomia njerëzore.

### LITERATURA

1. Zana Cikuli : Anatomia Normale e Njeriut. Tiranë 2002.
2. Zana Cikuli: Anatomia e njeriut. Cikël Leksionesh. Tiranë 2007.
3. Xh. Bakiri. K.Llanaj: Anatomia Normale e Njeriut. Tiranë 1986.
4. K.Llanaj. A.Ylli. M.Agolli D.Osmanlliu. S. Cule: Anatomia Normale e Njeriut. 1987.

### ANATOMIA NORMALE E NJERIUT

Pyetja 1.

Cili nga elementët e mëposhtëm, nuk bën pjesë në aparatën lëvizor të trupit:

- A. Kockat.
- B. Organet.
- C. Artikulacionet.
- D. Muskujt

Pyetja 2.

Cili nga funksionet e mëposhtme nuk i takon skeletit:

- A. Mbajtës.

- B. Mbrojtës.
- C. Lëvizor.
- D. Ndjesor.

Pyetja 3.

Shtresa e jashtme e kockës është:

- A. Peritoneumi
- B. Periosti
- C. Pleura
- D. Perikardi

Pyetja 4.

Cila nga kockat i takon regjionit të kërcirit:

- A. Humerusi
- B. Femuri
- C. Radiusi
- D. Fibula

Pyetja 5.

Nënvizo përgjigjen e drejtë: Shtylla kurrizore ka:

- A. 25 vertebra gjithsej
- B. 24 të lëvizshme
- C. 7 të regjionit të krahërorit
- D. 12 të regjionit të qafës

Pyetja 6.

Në formimin e kafazit të krahërorit merr pjesë:

- A. Sternumi
- B. Os kokse
- C. Skapula
- D. Ulna

Pyetja 7.

Në artikulacionin e gjurit merr pjesë:

- A. Tarsët
- B. Fibula
- C. Metatarsët
- D. Femuri

Pyetja 8.

Cili nga elementët nuk është i domosdoshëm për një artikulacion të lëvizshëm:

- A. Ligamenti.
- B. Lëngu sinovial.
- C. Kapsula.
- D. Disku.

Pyetja 9.

Artikulacioni që kryen lëvizje në tre boshte, është I tipit:

- A. Troklear
- B. Koklear
- C. Elipsoid
- D. Sferik

Pyetja 10.

Nënvizoni artikulacionin e tipit sferik:

- A. Art. skapulo – humeral
- B. Art. i brylit
- C. Art. radio karpal
- D. Art. i gjurit

Pyetja 11.

Dy artikulacione që kryejnë të njëjtat lëvizje kanë të përbashkët:

- A. Numrin e kockave.
- B. Numrin e ligamenteve.
- C. Sasinë e lëngut sinovial.
- D. Formën gjeometrike të tyre.

Pyetja 12.

Artikulacioni skapulo – humeral ka:

- A. Qëndrueshmëri të madhe dhe lëvizshmëri të madhe.
- B. Qëndrueshmëri të vogël dhe lëvizshmëri të vogël.
- C. Qëndrueshmëri të madhe dhe lëvizshmëri të vogël.
- D. Qëndrueshmëri të vogël dhe lëvizshmëri të madhe.

Pyetja 13.

Cila nga karakteristikat e mëposhtme nuk i takon muskulaturës së vijëzuar:

- A. E vullnetëshme.
- B. Vendoset mbi skelet.
- C. Lodhet shpejt.

D. Ka pak enë gjaku.

Pyetja 14.

Cila është karakteristikë e tendinit:

- A. Ka shumë enë gjaku.
- B. Lidh kockën me kockë.
- C. Ka pak mbaresa nervore.
- D. Lidh muskulin me kockën.

Pyetja 15.

Ka funksion lëvizor, mbrojtës, frymëmarës:

- A. M. i drejtë i barkut.
- B. M. i vogël i krahërorit.
- C. M. i gjatë i shpinës.
- D. M. i gjerë i shpinës.

Pyetja 16.

Cili muskul ndodhet në faqen e pasme të regjionit femoral:

- A. M. biceps femori
- B. M. pektineus
- C. M. iliak
- D. M. aduktor

Pyetja 17.

Muskuli që bën afrimin e kofshës është:

- A. M. soleus
- B. M. piriformis
- C. M. semitendinoz
- D. M. gracilis

Pyetja 18.

Cili nga muskujt ndodhet në regjionin e krahut:

- A. M. spinal
- B. M. trapez
- C. M. biceps brakial
- D. M. romboid

Pyetja 19.

Cili muskul ndodhet në regjionin e kërcirit:

- A. M. semitendinoz
- B. M. kuadriiceps
- C. M. gluteal
- D. M. gastroknemius

Pyetja 20.

Muskuli që kryen shtrirjen e trungut është:

- A. M. romboid
- B. M. triceps
- C. M. infraspinat
- D. M. spinal

Pyetja 21.

Muskuli shtrirës i krahut është:

- A. M. pektoralis major
- B. M. teres minor
- C. M. biceps brakial
- D. M. latissimus dorsi

Pyetja 22.

Muskuli që kryen dhe mbledhje, shtrirje, largim të krahut është:

- A. M. brakial
- B. M. triceps brakial
- C. M. deltoid
- D. M. brakoradial

Pyetja 23.

Cili muskul vë në lëvizje artikulationin skapulo humeral:

- A. M. brakial
- B. M. brakioradial
- C. M. trapez
- D. M. korakobrakial

Pyetja 24.

Muskuli që ngre brinjët lart është:

- A. M. interkostal
- B. Subkostal
- C. Levator kostarum
- D. Kostovertebral

Pyetja 25.

Në sistemin nervor qëndror (S.N.Q) bën pjesë:

- A. Nervat kronialë
- B. Nervat spinale
- C. Palca e kurrizit
- D. Nervat simpatik

Pyetja 26.

Në cilën pjesë të S.N.Q ndodhet qendra e kordinimit të ekuilibrit të trupit:

- A. Ura
- B. Palca e kurrizit
- C. Truri i mesëm
- D. Truri i vogël

Pyetja 27.

Receptorët e ndjeshmërisë superficiale janë të vendosur në:

- A. Lëkurë
- B. Organe
- C. Kocka
- D. Muskuj

Pyetja 28.

Cili organ nuk i takon aparatit tretës:

- A. Ezofagu
- B. Faringu
- C. Laringu
- D. Duodeni

Pyetja 29.

Cili nga organet ndodhet jashtë tubit tretës, por ndihmon tretjen:

- A. Shpretka
- B. Veshka
- C. Mëlçia
- D. Trakea

Pyetja 30.

Cili është organi i formimit të zërit:

- A. Faringu

- B. Laringu
- C. Trakea
- D. Bronket

Pyetja 31.

Shtresa e jashtme e zemrës është:

- A. Pleura
- B. Peritoneumi
- C. Perikardi
- D. Periosti

Pyetja 32.

Muskuli i zemrës ushqehet nga:

- A. Arteria koronare
- B. A. karotide
- C. A. vertebrale
- D. A. torakale

Pyetja 33.

Aorta e ka origjinën:

- A. Atrium i majtë
- B. Atrium i djathtë
- C. Ventrikul i majtë
- D. Ventrikul i djathtë

Pyetja 34.

Cila nga gjendrat e mëposhtme nuk është endokrine:

- A. Ovaret
- B. Testikuj
- C. Suprarenale
- D. Parotis

Pyetja 35.

Hormoni i rritjes së trupit prodhohet:

- A. Tiroide
- B. Hipofizë
- C. Epifizë
- D. Suprarenale

Pyetja 36.

Hormoni që ndikon në zhvillimin fizik dhe psiqik prodhohet në:

- A. Paratiroide
- B. Timus
- C. Tiroide
- D. Pankreas

Pyetja 37.

Mbaresat nervore që kapin ngacmimet e dritës janë vendosur:

- A. Sklerë
- B. Korne
- C. Retinë
- D. Iris

Pyetja 38.

Muskujt ciliarë ndodhen në:

- A. Gjuha
- B. Hunda
- C. Veshi
- D. Syri

Pyetja 39.

Nënvizoni formacionin anatomik që ka si funksion ekuilibrin:

- A. Hapësira timpanike
- B. Kërmilli
- C. Labirinti kockor
- D. Kockat e dëgjimit

Pyetja 40.

Nënvizoni formacionin anatomik që i takon lëkurës:

- A. Epiderma
- B. Endokardi
- C. Epifiza
- D. Endosti



## BIOMEKANIKA

Pyetja 1.

Cilët nga variablat e mëposhtëm janë kinematikë?

- A. Forca
- B. Puna
- C. Shpejtësia
- D. Fuqia

Pyetja 2.

Cili nga variablat e mëposhtëm nuk është i pavaruar nga mekanika njutoniane?

- A. Masa
- B. Hapësira
- C. Koha
- D. Forca

Pyetja 3.

Cila nga madhësitë e mëposhtme është variabël kinematik?

- A. Zhvendosja
- B. Forca
- C. Impulsi
- D. Puna

Pyetja 4.

Cila nga këto madhësi nuk është karakteristike e forcës si vektor:

- A. Pika e aplikimit
- B. Drejtimi
- C. Trashësia

D. Shenja

Pyetja 5.

Kur muskuli zgjatet, kontraksioni është :

- A. Koncentrik
- B. Izometik
- C. Izotonik
- D. Ekscentrik

Pyetja 6.

Leva është një kombinim i tre komponentëve që tregonjë një:

- A. Forcë
- B. Avantazh mekanik
- C. Zhvendosje
- D. Fuqi

Pyetja 7.

Cili është përkufizimi i masës së trupit?

- A. Sasia e lëndës në trup
- B. Masa e tërheqjes reciproke të trupave
- C. Shkalla e inercisë së trupit
- D. Raporti i peshës së trupit me nxitimin e rënies së lirë

Pyetja 8.

Lidhni planin me boshtin korrespondues:

- A. Plani frontal → Boshti transversal
- B. Plani transversal → Boshti longitudinal
- C. Plani sagital → Boshti Anteriposterior
- D. Plani transversal → Boshti Anteriposterior

Pyetja 9.

Veprimet e artikulacioneve rreth boshtit transversal dhe brenda planit sagital janë:

- A. Fleksion, ekstension, hiperekstension
- B. Abduksion, aduksion, eversion, devijim ulnar dhe radial
- C. Rrotullim i brendshëm dhe i jashtëm
- D. Pronacion, supinacion

Pyetja 10.

Matja direkte e inercisë në rrotullime përcaktohet nga:

- A. Masa
- B. Nxitimi
- C. Pesha
- D. Shpejtësia

Pyetja 11.

Cila nga këto formulime është një formë e energjisë mekanike?

- A. Energjia termike
- B. Energjia kimike
- C. Energjia diellore
- D. Energjia kinetike tejbartëse

Pyetja 12.

Presioni i gjakut tek një njeri në pozicionin e qendrimit verikal është:

- A. I njëjtë në të gjithë trupin
- B. Më i madh në tru
- C. Më i madh në gjymtyrët e poshtme
- D. Më i madh në gjymtyrët e sipërme

Pyetja 13.

Kur muskuli shkurtohet , puna gjatë këtij kontraksioni është:

- A. Pozitive
- B. Zero
- C. Negative
- D. Më e vogël ose e barabartë me zero.

Pyetja 14.

Cili nga formulimet e mëposhtme është i gabuar, nqse një objekt është në ekuilibër statik?

- A. Objekti ka shpejtësi konstante
- B. Forca rezultante është e barabartë me zero.
- C. Objekti qendron në prehje.
- D. Shuma e forcave është e ndryshme nga zero

Pyetja 15.

Faktorët që ndikojnë në forcën tërheqëse të një fluidi janë:

- A. Gjatësia e objektit
- B. Masa e fluidit
- C. Shpejtësia relative
- D. Koefiçenti i forcës tërheqëse

Pyetja 16.

Objektivi i atletit në aktivitetet sportive lidhet me këta faktorë:

- A. Tërheqja gravitacionale
- B. Energjia
- C. Koha e lëvizjes
- D. Masa e atletit

Pyetja 17.

Faktorët që ndikojnë në stabilitetin e një objekti:

- A. Përmasat dhe forma e bazës së mbështetjes
- B. Peshja e objektit
- C. Forca tërheqëse e tokës
- D. Forca e fërkimit

Pyetja 18.

Çfarë quhet forcë:

- A. Shkaku i lëvizjes së trupit
- B. Madhësia që shformon një trup ose ndryshon lëvizjen e tij
- C. Aftësia e trupit për të kryer punë
- D. Shkalla e inercisë së trupit

Pyetja 19/.

Nqse nuk marrim parasysh efektet e rezistencën së ajrit, shuma e forcave horizontale të ushtruara tek një gjimnaste kur ajo është në ajër është:

- A. E barabartë me zero
- B. Varet nga masa e gjimnastes
- C. E barabartë me peshën e gjimnastes
- D. Varet nga shpejtësia horizontale e gjimnastes

Pyetja 20.

Për pozicionimin e objektit në hapësirën 2D duhen:

- A. Një bosht dhe një koordinatë x, ose y
- B. Një bosht dhe dy koordinata x, y
- C. Dy boshte dhe dy koordinata x dhe y
- D. Tre boshte dhe tre koordinata x, y, z.

## **GJIMNASTIKË.**

Pyetja 1.

Prejardhja e fjalës “Gjimnastikë” është përdorur për herë të parë në:

- A) Në Romën e lashtë
- B) Në Athinën antike
- C) Në Egjiptin e lashtë
- D) Apo në Kinën e lashtë

Pyetja 2.

Në cilat qytetarime antike të shoqërisë skllavopronare zhvillohej Gjimnastika?

- A) Në Athinë
- B) Në Spartë
- C) Në Iliri

D) Në Romë

Pyetja 3.

Cilat nga këto vegla gjimnastikore u shpik nga Ludwig Jani (Gjerman)

- A) Kali me doreza
- B) Unaza
- C) Hekuri
- D) Pedana

Pyetja 4.

Kush nuk grupohet në llojet e gjimnastikës sipas drejtimit të “Profilizuar?”

- A) Me drejtim formues e zhvillues
- B) Me drejtim aplikativ
- C) Me drejtim sportiv
- D) Me drejtim “Cirku”

Pyetja 5.

Me drejtim formues e zhvillues nuk përfshihet gjimnastika:

- A) Themelore
- B) Higjenike
- C) Akrobatike
- D) Atletikore

Pyetja 6.

Në gjimnastikat me drejtim aplikativ nuk përfshihet?

- A) Gjim. Konvencionale
- B) Gjim. Kurativo-ortopedike
- C) Gjim. Aplikative
- D) Gjim. Për fëmijë (Baby-Gym etj.)

Pyetja 7.

Cilat nga këto disiplina të gjimnastikës nuk është sport olimpik?

- A) Gjim. Artistike (Meshkuj-Femra)
- B) Gjim. Ritmike (Femra)
- C) Gjim. Aerobike
- D) Trampolina

Pyetja 8.

Në periudhën e rilindjes nuk egzistonte sistemi gjimnastikor:

- A) Sistemi gjerman
- B) Sistemi francez
- C) Sistemi Suedez
- D) Sistemi Austriak

Pyetja 9.

Cilat nga disiplinat e gjimnastikës është pjesëmarrëse për herë të parë në lojrat Olimpike moderne te Athinës 1896?

- A) Gjimnastika Artistike
- B) Gjimnastika Ritmike
- C) Gjimnastika Aerobike
- D) Trampolina

Pyetja 10.

Cilat nga garat e gjimnastikës artistike me kampionatet botërore apo lojërat olimpike hap siparin?

- A) Gara kualifikuese
- B) Gara individual në shumëgarëshin gjimnastikor
- C) Gara individuale për kampion vegle
- D) Gara ekipore



Pyetja 11.

Këndi i parë sportiv në Shqipëri ne vegla gjimnastikore:

- A) Në shoqatën sportive “Vëllazëria” (1909)
- B) Në shoqatën sportive “Vllaznia” në Shkodër (1913)
- C) Në shkollën pedagogjike “Normalja” e Elbasanit (1916)
- D) Në Liceun Francez të Korcës

Pyetja 12.

Kur ka marrë pjesë për herë të parë në kampionatin ballkanik të gjimnastikës Shqipëria?

- A) Në Beograd (1946) - Jugasllavi
- B) Në Sofje (1947) – Bullgari
- C) Në Stamboll (1983) –Turqi
- D) Në Ploesht (1985) – Rumani

Pyetja 13.

Ushtrimet në veglat gjimnastikore klasifikohen në :

- A) Dy grupe kryesore
- B) Tre grupe kryesore
- C) Kater grupe kryesore
- D) Dy grupe kryesore

Pyetja 14.

Ushtrimet e gjimnastikës artistike janë reflekse apo lidhje refleksesh:

- A) Të kushtëzuara
- B) Të pakushtëzuara

- C) Të pamundura
- D) Imagjinare (fantazi)

Pyetja 15.

Ushtrimet që kryen me forcë janë më të vështira kur:

- A) Kalohet nga varja në mbështetje
- B) Nga mbështetja në varje
- C) Nga një varje më e lartë te një më e ulët
- D) Kur kalohet horizontalisht (Nga e majta apo e djathta)

Pyetja 16.

Kur janë më të vështira ushtrimet statike?

- A) Kur kanë kufizim të lëvizjes në ndërtimin anatomik të kycit
- B) Kur ky kufizim mungon
- C) Kur kanë peshë trupore të madhe
- D) Kur kanë shtatlartësi të madhe

Pyetja 17.

Gjatë rrotullimeve të ngjashme të ushtruesit rreth boshtit të veglës, afrimi i qendrës së gravitetit të truallit rreth këtij boshti të veglës:

- A) Zmadhon shpejtësinë e rrotullimit të trupit ul momentin e inercisë
- B) Zvogëlon shpejtësinë e rrotullimit të trupit dhe rrit momentin e inercisë
- C) Pengon në rrotullimin e trupit rreth boshtit të rrotullimit
- D) Fikson trupin në mosrrotullimin e tij rreth boshtit të rrotullimit

Pyetja 18.

Gjatë kërcimeve, fluturimeve akrobatike apo daljeve të ndryshme nga veglat gjimnastikore sasia e lëvizjeve mbetet madhësi:

- A) E ndryshueshme
- B) E pandryshueshme
- C) E njëtrajtshme
- D) Apo e përsheptuar

Pyetja 19.

Prirjet e zhvillimit të gjimnastikës artistike janë në drejtim të ushtrimeve:

- A) Dinamike
- B) Statike
- C) Dinamiko-statike
- D) Statiko-Dinamike

Pyetja 20.

Ushtrimet që kryhen me forcë e pozicionet statike janë më të vështira për ushtrues me peshë trupore të njëjtë dhe:

- A) Shtatlartësi të madhe
- B) Shtatlartësi të vogël
- C) Shtatlartësi të mesme
- D) Apo me disproporcion

Pyetja 21.

Prirjet e zhvillimit të gjimnastikës artistike janë në drejtim të ushtrimeve:

- A) Shpejtësi-forcë
- B) Forcë e mirëfilltë
- C) Qëndrueshmëri e mirëfilltë

D) Forcë-qëndrueshmëri

Pyetja 22.

Çfarë regjimi i kontraktimit të muskujve funksionon kur trupi i ushtruesit zhvendohet nga poshtë-lart bushtit të veglës?

- A) Në regjimin lëshues, zgjatës (eksentrik)
- B) Në regjimin fiksues i pozës, static (izometrik)
- C) Në regjimin oksotonik
- D) Në regjimin kontraktues (koncentrik)

Pyetja 23.

Çfarë regjimi i kontraktimit të muskujve funksionon kur trupi i ushtruesit zhvendohet nga lart-poshtë bushtit të veglës?

- A) Në regjimin lëshues, zgjatës (eksentrik)
- B) Në regjimin kontraktues (koncentrik)
- C) Në regjimin fiksues të pozës, static (izometrik)
- D) Në regjimin oksotonik

Pyetja 24.

Ushtrimet në trampolinë kanë karakter universal për metodikën e të mësuarit të elementëve të:

- A) Të gjimnastikës ritmike
- B) Gjimnastikës artistike
- C) Të gjimnastikës aerobike
- D) Të gjimnastikës

Pyetja 25.

Ushtrimet në trampolinë janë disiplinë e:

- A) Shumëgarshit të gjimnastikës artistike
- B) Sporteve akrobatike
- C) Gjimnastikës aerobike
- D) Sport i veçantë Olimpik

Pyetja 26.

Sa janë ushtrimet bazë të rënies (apo shtytjes) në trampolinë?

- A) Dy
- B) Katër
- C) Pesë
- D) Gjashtë

Pyetja 27.

Lëvizshmëria e unazave përcakton:

- A) Teknikën e ushtruesit
- B) Metodikën e të mësuarit
- C) Ndihmën e mbrojtjes
- D) Lidhjen me element të tjerë të mësuar

Pyetja 28.

Ushtrimet me kalë me doreza (tra ekuilibri për femra) kryen:

- A) Në varje
- B) Me rrotullim në varje
- C) Me kthim në varje
- D) Në mbështetje

Pyetja 29.

Ushtrimet në kalin me doreza (tra ekuilibri) karakterizohen nga :

- A) Dinamizmi i madh
- B) Pozicionet statike
- C) Ushtrimet demonstrative të shfaqjes së forcës
- D) Apo të alternuar pozicionet statike

Pyetja 30.

Për ruajtjen e ekuilibrit dinamik gjatë kryerjes së ushtrimeve në kalin me doreza (tra ekuilibri) ndikon në mënyrë jofavorizuese:

- A) Lartësia e veglës që përdoret
- B) Gjatësia e veglës që përdoret
- C) Ndërrimi i shpejtë i sip. mbështetëse
- D) Apo fortësia e veglës

Pyetja 31.

Gjatë kryerjes së rrotullimeve rreth boshtit të hekurit zvogelimi i rrezes së trupit:

- A) Zmadhon shpejtësinë e lëvizjes
- B) Zvogëlon shpejtësinë e lëvizjes
- C) Bllokon shpejtësinë e lëvizjes
- D) Apo fikson pozicionin e trupit në qëndrim

Pyetja 32.

Gjatë kryerjes së ngritjes me shpalosje e në hekur, ndihma i jepet ushtruesit:

- A) Me të dy duart në shpinë

- B) Me të dy duart te këmbët
- C) Një dorë tek këmbët , tjetra shpinë
- D) Apo me duart te gjoksi

Pyetja 33.

Ushtrimet në paralele (P/SH femra) përfshijnë sipas klasifikimit:

- A) Të gjitha grupet strukturore të kryerjes së ushtrimeve në këto vegla
- B) Disa prej tyre
- C) Vetëm ushtrimet dinamike në këto vegla
- D) Vetëm ushtrimet statike në këto vegla

Pyetja 34.

Për kryerjen e kërcimeve me mbështetje të llojeve të ndryshme kërkohet:

- A) Vrapim i përshpejtuar me shpejtësi maksimale për kërcimin e dhënë
- B) Vrapim i përshpejtuar me shpejtësi optimale për kërcimin e dhënë
- C) Vrapim i përshpejtuar me shpejtësi mesatare për kërcimin e dhënë
- D) Vrapim i përshpejtuar me shpejtësi të vogël për kërcimin e dhënë

Pyetja 35.

Klasifikimi i kërcimeve me mbështetje nuk përfshin:

- A) Kërcimet e drejta
- B) Kërcimet me rrotullim
- C) Kërcimet e zhdrejta
- D) Kërcimet me salto

Pyetja 36.

Prirjet e sotme të zhvillimit të ushtrimeve akrobatike janë drejt:

- A) Ushtrimeve dinamike
- B) Ushtrimeve statike
- C) Ushtrimeve dinamiko-statike
- D) Apo ato të forcës së ngadalshme

Pyetja 37.

Ku i jepet ndihma ushtruesit në rrotullimin para në akrobaci:

- A) Të dyja duart të vendosura me kujdes prapa shpinës
- B) Të dyja duart te krahët e ushtruesit në kohën e duhur
- C) Apo me njëren dorë tek shpina e ushtruesit
- D) Me njëren dorë të kthyer të kapur tek krahu, tjetra te shpina

Pyetja 38.

Veglat e dorës së gjimnastikës ritmike janë?

- A) Dy llojesh
- B) Tre llojesh
- C) Katër llojesh
- D) Pesë llojesh

Pyetja 39.

Garat e gjimnastikës ritmike zhvillohen:

- A) Vetëm nga vajzat
- B) Vetëm nga meshkujt
- C) Miks djem-vajza



D) Miks vajza-djem

Pyetja 40.

Garat e gjimnastikës ritmike kryen:

- A) Pa muzikë
- B) Me muzikë me tekst
- C) Me muzikë
- D) Me instrument popullor

## **DIDAKTIKË**

Pyetja 1.

Cila nga fushat e edukimit fizik studion efektet e ushtrimeve mbi trupin deri në nivelin qelizor:

- A) Fiziologjia e të ushtruarit.
- B) Anatomia .
- C) Biologjia sportive.
- D) Biokimia.

Pyetje 2.

Me plotshëndetmëri kuptojmë:

- A) Mospirjen e duhanit, alkolit, drogës etj.
- B) Gjëndjen e mirë të sistemit kardiovaskular, strukturës së trupit, forcës e fleksibilitetit.
- C) Mbajtjen e një regjimi të rreptë ditor.
- D) Përmirësimin e shpejtësisë, qëndrueshmërisë e fleksibilitetit.

Pyetje 3.

Fëmijët 2-5 vjeç i mësojnë veprimet lëvizore me anë të skemës:

- A) S-R (stimul-reagim).
- B) Orientim, zbatim, kontroll-korigjim, sukses i pritur.
- C) Provë, gabim, vetkorigjim, sukses.
- D) Njohjen, shoqërimin, pavarësinë.

Pyetje 4.

Fëmijët 6-10 vjeç i mësojnë veprimet lëvizore me anë të skemës:

- A) Njohjen, shoqërimin, pavarësinë.
- B) S-R (stimul-reagim).
- C) Provë, gabim, vetkorigjim, sukses.
- D) Orientim, zbatim, kontroll-korigjim, sukses i pritur.

Pyetje 5.

Nëpërmjet cilave etapa fitohet mjeshtria lëvizore:

- A) Njohjen, shoqërimin, pavarësinë.
- B) S-R (stimul-reagim).
- C) Provë, gabim, vetkorigjim, sukses.
- D) Orientim, zbatim, kontroll-korigjim, sukses i pritur.

Pyetje 6.

Cila nga këto karakteristika është elementi dallues i shkathtësisë lëvizore:

- A) Qëndrueshmëria e rezultatit.
- B) Shpejtësia e lartë e lëvizjeve.
- C) Paqëndrueshmëria e rezultatit.
- D) Automatizimi i veprimit.

Pyetje 7.

Cila nga këto karakteristika është elementi dallues i shshprehisë lëvizore:

- A) Ngadalësim i ekzekutimit.
- B) Automatizim i operacioneve.
- C) Paqëndrueshmëri e rezultatit.
- D) Kontroll i vetëdijshëm në të gjitha pikat mbështetëse.

Pyetje 8.

Cilat janë karakteristikat themelore të përmbajtjes së edukimit fizik:

- A) Kapitulli, nënlinja, çështjet mësimore.
- B) Aftësitë lëvizore bazë, vallëzim ritmik, manipulim lëvizor.
- C) Të dish se, të dish si, të dish pse, të dish të.
- D) Njohuri të veprimeve lëvizore bazë, veprime lëvizore sportive, cilësitë fizike.

Pyetje 9.

Në organizimin e mësimit të edukimit fizik, cilët janë elementët ku mbështetet mësuesi për realizimin me cilësi të procesit të të mësuarit:

- A) Përgatitja materiale, udhëzime të organizimit të procesit mësues.
- B) Udhëzime për mënyrën e fillimit të aktivitetit, udhëzime për përfundimin e aktivitetit dhe udhëzime për mbrojtjen gjatë mësimit.
- C) Tipet e mësimit dhe karakteristikat e tyre, format e organizimit të mësimit, format e vendosjes së nxënësve në orën e mësimit.
- D) Njohja me grupin mësues, njohja me nivelin fillestar të zhvillimit fizik e psikomotor.

Pyetje 10.

Cilët janë tipet e mësimeve të edukimit fizik mbi bazën e synimeve special

- A) Mësimet përgatitore dhe mësimet e kombinuara.
- B) Mësimet me material të ri dhe mësimet përsëritëse.
- C) Mësimet e kontrollit dhe mësimet në formë loje e gare.
- D) Mësimet e përgatitjes së përgjithshme, mësimet e specialitetit sportiv dhe mësimet e instruktazhit metodik.

Pyetje 11.

Cila është forma më e zakonshme organizative e punës në orën e mësimit të edukimit fizik:

- A) Forma frontale.
- B) Forma zinxhir.
- C) Forma në grupe.
- D) Forma individuale.

Pyetje 12.

Kur rreshtohen nxënësit në orën e mësimit të edukimit fizik, mësuesi duhet të vendoset me ndriçimin:

- A) Përballë vetes.
- B) Majtas vetes.
- C) Djathtas vetes.
- D) Mbrapa vetes.

Pyetje 13.

Një organizim i efektshëm i procesit të të mësuarit duhet:

- A) Të transmetojë udhëzime të organizimit të procesit mësues.

- B) Të lejojë rritjen e kohës së të ushtruarit individual.
- C) Të ruajë dhe të zhvillojë forcën, shpejtësinë e qëndrueshmërinë.
- D) Të ruajë dhe të zhvillojë koordinimin lëvizor, barazpeshimin, saktësinë.

Pyetje 14.

1. Në teknikën e ushtrimeve fizike dallojmë:
  - A) Fazën përgatitore, themelore dhe përfundimtare.
  - B) Pozicionin e pjesëve të trupit para fillimit të veprimit.
  - C) Veçoritë morfologjike dhe funksionale të njeriut.
  - D) Bazën orientuese, pikat mbështetëse dhe detajet.

Pyetje 15.

Metodika e edukimit fizik ka të bëjë me:

- A) Karakteristikat dhe përmbajtjen e mësimit.
- B) Parashikimin e objektivave të përgjithshme.
- C) Tërësinë e metodave, format, mënyrat e mjetet e mësimit.
- D) Krijimin e kushteve nga mësuesi për ta bërë mësimit më të efektshme.

## **LOJRA LËVIZORE**

Pyetja 1.

Lojrat lëvizore janë kombinime veprimesh fizike:

- A) Me e mbi vegla didaktike
- B) Me objekte rrethore
- C) Me objekt të përcaktuar
- D) Me synime konkrete afatgjata

Pyetja 2.

Edukimi lëvizor është proces:

- A) Filozofik
- B) Sportiv
- C) Sociologjik

## D) Pedagogjik

Pyetja 3.

Edukimi lëvizor bëhet i suksesshëm, i realizon objektivat e qëllimet e përcaktuara, në qoftë se organizohet dhe drejtohet me:

- A) Pikësynime të qarta, me nivel të lartë ose mjeshtëri pedagogjike
- B) Programe të përpunuara dhe të miratuara më parë
- C) Një trupë pedagogjike të trainuar dhe të provuar më parë
- D) Këndvështrime psiko-filozofike sipas situatës konkrete që paraqitet

Pyetja 4.

Edukimi lëvizor realizohet duke u mbështetur në parimet themelore të :

- A) Filozofisë moderne
- B) Sociologjisë moderne
- C) Pedagogjisë moderne
- D) Fiziologjisë modern

Pyetja 5.

Kontributi që edukimi lëvizor sjell në zhvillimin e tërë personalitetit të individit (nxë nësit) karakterizon atë që quhet:

- A) Edukim me anë të punës
- B) Edukim me anë të sakrificës
- C) Edukim me anë të lëvizjes
- D) Edukim me anë të stërvitjes

Pyetja 6.

Suksesi i realizimit dhe i të shfaqurit të lëvizjeve sipas kërkesave, detyrave, qëllimit, varet nga faktorët:

- A) Fizikë, psikikë e volitive
- B) Ekonomikë, socialë e politikë
- C) Familjarë, zonalë e kulturorë
- D) Buxhetorë, financiarë e personalë

Pyetja 7.

Të kuptosh se si duhet të realizohet Lëvizja, do të thotë të jesh në gjëndje ta diferencosh atë në :

- A) Mënyrë të plotë e sinjifikative
- B) Formë korrekte dhe të plotë
- C) Në hapësirë dhe në kohë
- D) Amplitudë dhe ritëm

Pyetja 8.

Shkalla dhe cilësia e përvëtsimit të shprehive lëvizore së bashku me karakteristikat gjenetike diferencen ose seleksionon:

- A) Karakteristikat bazë të nxënësve dhe grupit
- B) Nivelin ekonomik dhe kulturor të familjes
- C) Nxënësin e talentuar për një sport të caktuar
- D) Ngarkesën e duhur për grupime të veçanta

Pyetja 9.

Sipar teorise homeostatike, njerë zit lëvizin dhe veprojnë me qëllim që të ruajnë , por dhe te rivendosin:

- A) Psikologjinë
- B) Ekuilibrin
- C) Ngarkesën
- D) Intensitetin

Pyetja 10.

Skinner me teorine e perpunimit te kushtezimit ka krijuar mundesine e nje modeli qe lejon:

- A) Modifikimin e sjelljes
- B) Ekuilibrimin psiqik
- C) Rakordimin e ngarkesës
- D) Vazhdimësinë e punës

Pyetja 11.

Me termin "kapacitet" (zotesi) duhet të kuptohet niveli më i lartë i:

- A) Aftësive kondicionale e motorre
- B) Rendimentit në punë e jetë

- C) Aftësive fizike lëvizore
- D) Arritjeve në sport dhe aktivitet

Pyetja 12.

Koha për mësim dhe arritja e pjekurisë së shprehive lëvizore janë gjithmonë në varësi dhe plotësisht:

- A) Racionale
- B) Individuale
- C) Fundamentale
- D) Kolektive

Pyetja 13.

Lëvizja si proces human ka kuptim:

- A) Fizik e filozofik
- B) Fiziologjik dhe emocional
- C) Social e kulturor
- D) Didaktik e zhvillimor

Pyetja 14.

Në aspektin e edukimit të veprimeve lëvizore është e domosdoshme njohja e:

- A) Mjedisit ku operojmë
- B) Kapacitetit fizik të nxënësve
- C) Formimit aktual
- D) Personalitetit të subjekteve

Pyetja 15.

Metoda më rezultative e edukimit lëvizor dhe e edukimit nëpërmjet lëvizjes është :

- A) Metoda empirike
- B) Metoda konkrete
- C) Metoda parciale
- D) Metoda e Lojës

Pyetja 16.

Posturat janë skema tredimensionale, ndërsa lëvizjet janë skema:

- A. Dinamike katërdimensionale

- B. Statike tredimensionale
- C. Balistike dydimensionale
- D. Futuriste konceptuale

Pyetja 17.

Me struktura lëvizore duhet të kuptohen tërësia e skemave të një grupimi aktesh motore:

- A. Me ngjashmëri strukturore në formë
- B. Me shpejtësi e ritëm të njëjtë lëvizor
- C. Me karakteristika lëvizore të përafërta
- D. Me formim të hershëm sportive

Pyetja 18.

Të gjitha segmentet e trupit që marrin pjesë në lëvizje përbëjnë :

- A) Formimin bazë lëvizor
- B) Strukturën anatomike motore
- C) Zinxhirin e veprimeve
- D) Hallkat bazë të reagimit

Pyetja 19.

Loja është një mënyrë e të jetuarit, është një ekspresion autentik i aftësive për të jetuar dhe rrënjët e saj i përkasin:

- A) Shtresave më të thella të ekzistencës së shoqërisë
- B) Grupimeve kryesore autentike të popullsisë
- C) Të gjithë atyre që kanë kontribuar për të
- D) Shoqërive që në lashtësi e në kohët modern

Pyetja 20.

Loja është veprimtari e dëshirueshme, sepse në lirinë e zgjedhjes dhe të realizimit të saj rezultojnë :

- A) Emocione dhe ëndërra të realizuara
- B) Kënaqësi thellësisht të natyrës afektive
- C) Ajo të heq stresin dhe lodhjen e ditës
- D) Dëshira të grupeve për shoqërizim

Pyetja 21.

Për fëmijët Loja është një çështje me rëndësi parësore jetësore dhe:



- A) Ka lindur së bashku me ta
- B) Ka një vend kryesor në jetën e tyre
- C) Ka rëndësi formuese e edukative
- D) Ka efekte të një game të gjërë

Pyetja 22.

Karakteristikë e veçantë e lojërave tradicionale shqiptare është karakteri tepër:

- A) I ngadaltë i tyre
- B) Progresiv i tyre
- C) Dinamik i tyre
- D) Tradicional i tyre

Pyetja 23.

Nëpërmjet lojërave lëvizore nxënësi përvetëson shprehitë fizike koordinative dhe kondicionale në:

- A) Mënyrë të natyrëshme
- B) Formë të drejtpërdrejtë
- C) Mënyrë të sforcuar
- D) Drejtim të zhvillimit harmonik

Pyetja 24.

Elementi më themelor në lojërat lëvizore dhe baza e kësaj veprimtarie është:

- A) Kërcimi
- B) Hedhja
- C) Saktësia
- D) Vrapimi

Pyetja 25.

Loja në përgjithësi e lojërat lëvizore në veçanti, do të marrin përparësi në procesin e edukimit duke u konsideruar si mjete dhe metoda:

- A) Pedagogjike më rezultative
- B) Psikologjike më efikase
- C) Bazë e edukimit motor
- D) Moderne e së ardhmes

Pyetja 26.

Për vlerat e mëdha edukative, loja është cilësuar edhe metoda më e mirë:

- A) Filozofike
- B) Konceptuale
- C) Pedagogjike
- D) Sociologjike

Pyetja 27.

Lojëra lëvizore zbavitëse do të emërtohen të gjitha ato lojëra të cilat gjatë zhvillimit të tyre krijojnë :

- A) Momente të këndëshme emocionale
- B) Situata konfliktuale absurde
- C) Gjëndje të pasigurisë e ankthit
- D) Kushte për një zhvillim spontan fizik

Pyetja 28.

Në metodën e lojës rëndësinë më të madhe e merr zgjedhja e lojës e cila në përmbajtjen e saj nuk duhet të ketë asnjë dukuri që nxit:

- A) Fanatizmin
- B) Agresivitetin
- C) Surealizmin
- D) Shoqërizimin

Pyetja 29.

Mësuesi duhet ta njohë mirë lojën, të shpjegojë qartë formën e zhvillimit të saj, qëllimin dhe të ndjekë një rrugë sa më të kujdesëshme:

- A) Artistike
- B) Emocionale
- C) Metodike
- D) Krijuese

Pyetja 30.

Me aftësi eksteroreceptive duhet të kuptohet ndjeshmëria perceptuese e:

- A) Organeve të tretjes
- B) Organeve të frymëmarrjes
- C) Organeve të shqisave
- D) Organeve të gjakut

## MASAZH E KINEZIOTERAPI

Kjo lëndë është parashikuar të jetë pjesë përbërëse e programit për provimin e shtetit për mësuesit e edukimit fizik.

**Tematika e përzgjedhur** (përmbajtja e lëndës) bazohet në kompetencat që duhet të zotërojë një kandidat për mësues i edukimit fizik në formimin e tij profesional.

Ky program bazohet në:

- Njohuritë mbi masazhin dhe metodikat e tij, ndërtimin e lëkurës.
- Teknikat e gjimnastikës korigjuese dhe përdorimi i saj.
- Të jetë i aftë të zbatojë në mënyrë korrekte terapinë lëvizore në traumat e ndryshme të organizmit të njeriut.
- Të njohi mirë ndërtimin e organizmit të njeriut dhe të ndërhyjë në deviacionet e mundëshme të kolonës vertebrale, të kafazit të krahërorit dhe të gjymtyrëve të poshtme.
- Njohuri përkatëse në programimin dhe në trajtimin e patologjive të ndryshme në organizmin e njeriut duke përdorur terapinë lëvizore.

### **Literaturë e kërkuar:**

1. *Kapedani K. Prifti Dh. Masazhi Sportiv. (1997) Tiranë.*
2. *Canaj P. Kapedani K. Canaj F. Kinezoterapia. (2008) Tiranë.*
3. *Williams Arpour. A guide treatment and rehabilitation of injuries in sport, 1998.*

### **MASAZHI.**

Pyetja 1. V)

Mekanizmi fiziologjik i muskulit kushtëzohet nga ngacmimi i :

- A. Sistemit kardiovaskular.
- B. Sistemit muskuloskeletik.
- C. Neuro – Hormonal.
- D. Gastro – Intestinal.

Pyetja 2. V)

Kure nuk duhet te bejme masazh:

- A. Perpara gares.
- B. Gjate gares.
- C. Menjehere pas gares.
- D. Disa ore pes gares.

Pyetja 3. V)

Masazh duhet te aplikohet ne ambiente me tempratura :

- A. 12-16 °
- B. 18-24 °
- C. 26-30
- D. 30-34 °

Pyetja 4. V)

Kush eshte shtresa e pere e epidermes :

- A. Shtresa germinative.
- B. Shtresa spinoze.
- C. Shtresa granuloze.
- D. Shtresa lucidum

Pyetja 5. V)

Cili nga llojet e masazhit aplikohet i pari.

- A. Ferkimi.
- B. Shtrydhja.
- C. Lëmimi
- D. Vibrimi.

Pyetja 6. V)

Gjatë lëmimit duart duhet të lëvizin:

- A. Në drejtim të njëjtë me qarkullimin venoz.
- B. Në drejtim të kundërt me qarkullimin venoz.
- C. Në drejtim orar.
- D. Në drejtim kundër orar.

Pyetja 7. V)

Cila nga menyrat e shkrifjes eshte me qetesuese:

- A. Shkrifja e thjeshtë me një dorë.
- B. Shkrifja dyfishunazore
- C. Shkrifje gjatësore.
- D. Shkrifja pincore.

Pyetja 8. V)

Kush nga mënyrat e shtrydhjes nuk aplikohet:

- A. Shtrydhja e thjeshtë me një dorë.
- B. Shtrydhja e thjeshtë medy duar.
- C. Shtrydhja e thjeshtë me shtypje.
- D. Shtrydhja e thjeshtë pa shtypje.

Pyetja 9. V)

Kush nga mënyrat goditëse nuk aplikohet:

- A. Grushtimi
- B. Pickimi
- C. Goditja
- D. Rrahja

Pyetja 10. V)

Gjatë aplikimit të mënyrave goditëse kush nga artikulacionet nuk merr pjesë në lëvizje:

- A. Artikulacioni radeo karpal
- B. Artikulacioni kokso femoral
- C. Artikulacioni kubital
- D. Artikulacioni skapulo humeral

Pyetja 11. V)

Cila nga gjimnastikat duhet te aplikohet e para:

- A. Gjimnastika normale aktive
- B. Gjimnastika normale passive

- C. Gjimmastika aktive me kunderveprim
- D. Gjimmastika pasive me kunderveprim

Pyetja 12. V)

Kur masazhi kunderindikohet:

- A. Kur sportisti eshte i lodhur
- B. Kur sportisti ben pushim gjate gares.
- C. Kur sportisti eshte para gares.
- D. Kur ka infeksion te lekures

Pyetja 13. V)

Aplikimi i mënyrave të masazhitduhet të jetë.

- A. I ngadalshëm.
- B. I shpejtë.
- C. Shumë i shpejtë.
- D. Graduale.

Pyetja 14. V)

Cili nga llojet e masazhit ka efektin kryesor në shplodhjen e muskujve:

- A. Lëmimi.
- B. Fërkimi.
- C. Shkrifja.
- D. Shtrydhja.

Pyetja 15. V)

Cili nga llojet e masazhit ka efekt kryesor ne shplodhjen e artikulacioneve.

- A. Lëmimi.
- B. Fërkimi.
- C. Shkrifja.
- D. Dridhja.

## **KINEZOTERAPI**

Pyetja 1.

Kifoza është deformimi i:

- A. Gjymtyrëve të poshtme

- B. Gjymtyrëve të sipërme
- C. Shtyllës kurrizore
- D. I kafkës

Pyetja 2.

Kifoza është deformimi:

- A. Në planin sagital
- B. Në planin frontal
- C. Në planin antero-posterior
- D. Në planin vertikal

Pyetja 3.

Llojet e kifozave nuk janë:

- A. Rakitike
- B. Mosha e rinisë
- C. Traumatike
- D. Sociale

Pyetja 4.

Cili nuk është i rregullt si perifrazim:

- A. Dystabani është statik
- B. Dystabani është paralitik
- C. Dystabani është stabilizues
- D. Dystabani është traumatik

Pyetja 5.

Genu valgum është:

- A. Forma X
- B. Forma O
- C. Forma  $\delta$  (delta)
- D. Forma  $\Phi$  (Omega)

Pyetja 6.

Genu varum është forma:

- A. Forma O
- B. Forma  $\delta$  (delta)
- C. Forma  $\Phi$  (Omega)
- D. Forma X

Pyetja 7.

Skolioza është deformim:

- A. Artikulacioni skapulo humeral
- B. Artikulacioni kokso femoral
- C. Artikulacioni i vertebrave
- D. Artikulacioni i gjurit

Pyetja 8.

Skolioza është deformim i kollonës vertebrale në planin:

- A. Vertikal
- B. Longitudinal
- C. Antërio postërior
- D. Frontal

Pyetja 9.

Trajtimi i paraplegjikut konsiston në:

- A. Forcimin e anësive të sipërme
- B. Forcimin të anësive të poshtme
- C. Forcimin e muskujve të faqeve
- D. Forcimi i muskujve të qafës

Pyetja 10.

Hemiplegjia është paralizë e:

- A. Gjymtyrëve të sipërme
- B. Gjymtyrëve të poshtme.
- C. E gjysmës së trupit
- D. E gjithë trupit.

Pyetja 11.

Lordoza është deformim i:

- A. I gjymtyrëve të sipërme.
- B. I gjymtyrëve të poshtme.
- C. I kolonës vertebrale.
- D. Kafkës.

Pyetja 12.

“Gjoksi i pulës” është:

- A. Kafazi i krahavorit i dalë.
- B. Kafazi i krahavorit i sheshtë.
- C. Kafazi i krahavorit i futur brenda.
- D. Asnjëra.



Pyetja 13.

Për trajtimin e arteritit nuk këshillohet:

- A. Gjimnastikë të tipit byrger
- B. Ushtrime aktive për të gjitha gjymtyrët
- C. Kontrolllohet e ecura
- D. Masazhi në anësi

Pyetja 14.

Shtrembërimet e kafazit të kraharorit nuk janë:

- A. I sheshtë
- B. I shtypur
- C. I hapur
- D. I dale

Pyetja 15.

Arteritis është inflamacion i:

- A. Enëve të gjakut arterial
- B. Enëve të gjakut venoz
- C. Enëve të limfës
- D. Rrugëve të frymëmarrjes

## **TEKNOLOGJI TË REJA**

Pyetja 1.

Sensi magjik i teknologjisë, duket në tiparin:

- A) Mbarë funksionues të saj
- B) Multifunksionues të saj
- C) Mosfunksionues të saj
- D) Unifunksionues të saj

Pyetja 2.

Besimi në teknologji ka lidhet me:

- A) Teknicizmin
- B) Mekanizmin
- C) Zhvillimin teknologjik
- D) Tendencën e zhvillimit.

Pyetja 3.

Analiza kinematike e një trupi në sport arrihet :

- A) Nëpërmjet analizës 3D
- B) Nëpërmjet analizës 2D
- C) Nëpërmjet analizës së rrjedhës Optike
- D) Nëpërmjet analizës antropometrike

Pyetja 4.

Teknologjia magnetike përdoret në:

- A) Pajisjet ergometrike
- B) Analizatorët kinematik
- C) Pedometrat
- D) Akselerometrat

Pyetja 5.

Teknologjia në matjet e disiplinave të hedhjeve:

- A) Bazohet në analizën balistike.
- B) Bazohet në matjet me lazer.

- C) Bazohet në teknologjinë GPS
- D) Bazohet në matjen e shpejtësisë.

Pyetja 6.

Aksesibiliteti i faqes WEB është funksion:

- A) Në nivel klienti
- B) Që kryhet lokalisht
- C) Që varet nga serveri
- D) Që varet nga lidhja e internetit

Pyetja 7.

BIT-i është:

- A) Elementi (0,1) në nivel atomik në sistemin binar
- B) Njësi elektrike elementare
- C) Mundësi transmetimi të dhënash
- D) Shumfish i byte

Pyetja 8.

Për matjen e kalorive të djegura në punë, përdoret:

- A) Metoda kalorimetrike
- B) Metoda antropometrike
- C) Metoda ergometrike
- D) Metoda e peshimit

Pyetja 9.

Ç'është më e rëndësishme, në ndërtimin e sipërfaqes së pistave të garave,

- A) Llogaritja e koeficientit të aderencës
- B) Llogaritja e koeficientit të elasticitetit
- C) Llogaritja e koeficientit të plasticitetit
- D) Llogaritja e kurbave të kthesave

Pyetja 10.

Teknologjia e kompjuterave zhvillohet bazuar në:

- A) Ligjin e Amdahlit
- B) Ligjin e Ohmit
- C) Ligjin e Gravitetit
- D) Ligjet e Njutonit

## ATLETIKË

### I. Pyetje me karakter bazik dhe njohës

Pyetja 1.

Ç'është Atletika?

- A) Është disiplinë sportive me përmbajtje të gjithanshme dhe aplikative ?
- B) Është disiplinë sportive me lloje ciklike dhe aciklike?
- C) Është disiplinë sportive që funksionon mbi ecjet, vrapimet, kërcimet dhe hedhjet?
- D) Është disiplinë sportive me ushtrime të karakterit fizik, funksional dhe kordinativ?

Pyetja 2.

Cilat nga fushat e zbatimit të Atletikës është më e vështirë?

- A) Është fusha për fitness-in?
- B) Është fusha për përgatitjen e përgjithshme në lloje sporti?
- C) Është fusha e zbatimit sipas programeve mësimore në shkollë?

D) Është fusha për arritje të larta sportive në një disiplinë të caktuar?

Pyetja 3.

Cilat nga fushat e zbatimit të Atletikës është më shëndetdhënëse?

- A) Është fusha për arritje sportive?
- B) Është fusha për fitness-in në kategori të ndryshme të moshës?
- C) Është fusha për përgatitjen sportive fizike e lëvizore?
- D) Është për zbatim koordinativ e kulturor?

Pyetja 4.

Ç'është vrapimi atletik?

- A) Është bashkësi veprimesh jo rrethore me karakter shpërthyes dhe të shkëputura?
- B) Është kombinim veprimesh me shkëputje progresive dhe në vijueshmëri?
- C) Është bashkësi veprimesh ciklike, i realizuar nëpërmjet hapave me fazë shkëputje nga trualli?
- D) Është kombinim veprimesh me faza shkëputje dhe përshpejtuese?

Pyetja 5.

Ç'është hapi i vrapimit?

- A) Është distanca e shkëputjeve vertikale në fazën e fluturimit?
- B) Është hapësira ndërmjet dy prekjeve të këmbëve, e ndërmjetësuar nga një fazë shkëputjeje nga trualli?
- C) Është dëndësia mesatare e hapave në vrapimin e lirë?
- D) Është distanca mesatare e hapave në vrullin e nisjes?

Pyetja 6.

Kush është njësia matëse e hapit të ecjes dhe vrapimit atletik?

- A) Është “hapa në sekond”?
- B) Është “hapa në minutë”?
- C) Është “metri” dhe nënfishat” e tij?

D) Është “sasia e hapave në minutë”?

Pyetja 7.

Cilat nga fazat e vrapimit atletik është më e rëndësishme?

- A) Është faza e shkëputjes?
- B) Është faza njëmbështetëse?
- C) Është faza reaguese?
- D) Është faza përshpejtuese?

Pyetja 8.

Cili është elementi më i rëndësishëm në fazën njëmbështetëse dhe në rrahje gjatë vrapimit dhe kërcimit atletik?

- A) Është elementi i amortizimit (i zbutjes)?
- B) Është elementi i shtytjes?
- C) Është elementi i ngritjes me dy këmbë?
- D) Është elementi i prekjes?

Pyetja 9.

Në cilin element të fazës një mbështetëse (në vrapime) dhe gjatë rrahjes (në kërcime) zbatohet reaksioni i përparshëm?

- A) Gjatë prekjes?
- B) Gjatë zbutjes (amortizimit)?
- C) Gjatë shtytjes?
- D) Gjatë shjëputjes?

Pyetja 10.

Në cilat disiplina të vrapimeve arrin madhësia më e madhe e hapit?

- A) Në vrapimet e shpejtësisë?
- B) Në vrapimet e mesme?
- C) Në vrapimet e gjata?
- D) Në vrapimet shumë të gjata?

Pyetja 11.

Cili është elementi kryesor në fazën njëmbështetëse (në vrapimin) dhe në rrahje (në kërcimin atletik)?

- A) Është vrulli?
- B) Është prekja?
- C) Është shtytja?
- D) Është fluturimi?

Pyetja 12.

Ç'është dëndësia e hapave në vrapimin atletik?

- A) Është madhësi e hapit në njësinë e kohës?
- B) Është sasia e hapave në një distancë të caktuar?
- C) Është sasi lëvizjesh të përsëritura?
- D) Është sasia e hapave në njësinë e kohës (hapa/sek)?

Pyetja 13.

Në cilat disiplina atletike arrin dëndësia më e madhe e hapave?

- A) Në vrapimet shumë të gjata
- B) Në vrapimet e shpejtësisë?
- C) Në vrapimet e mesme?
- D) Në vrapimet me pengesa?

Pyetja 14.

Në cilat gara të vrapimeve atletike zgjat më shumë vrulli i nisjes?

- A) Në vrapimet e gjata?
- B) Në vrapimet e mesme?
- C) Në vrapimet e shpejtësisë?
- D) Në vrapimet shumë të gjata?

Pyetja 15.

Cilat nga fazat e vrapimit atletik është më e rëndësishme?

- A) Është faza e shkëputjes?
- B) Është faza njëmbështetëse?
- C) Është faza reaguese?
- D) Është faza përshpejtuese?

Pyetja 16.

Në cilat faza teknike të vrapimit atletik arrijnë maksimumin e tyre forcat e inercisë?

- A) Gjatë nisjes dhe vrullit të nisjes (startit)?
- B) Gjatë reagimit të nisjes dhe vrapimit në distancë?
- C) Gjatë sulmit për mbërritje dhe në mbërritje?
- D) Gjatë vrapimit në kthesë dhe në vijë të drejtë?

Pyetja 17.

Ç'është kërcimi atletik?

- A) Është kombinim veprimesh ciklike dhe të rrjedhshme me veprime të shpejta?
- B) Është kombinim veprimesh shpërthyes aciklike me fazë pa mbështetje të gjatë?
- C) Është kombinim veprimesh ciklike-aciklike me karakter përshpejtues?
- D) Është Kombinim veprimesh të dendura dhe në vijueshmëri?

Pyetja 18.

Në cilin element të fazës një mbështetëse në vrapim dhe gjatë rrahjes në kërcime arrin ngarkesa dhe shpejtësia më e madhe e q.p.r.?

- A) Gjatë elementit të shtytjes?



- B) Gjatë elementit të prekjes?
- C) Gjatë elementit të zbutjes?
- D) Gjatë shkëputjes?

Pyetja 19.

Ç'është hedhja atletike?

- A) Është bashkësi veprimesh aciklike dhe shpërthyese që realizon zhvendosjen e veglave në hapësirë e në kohë?
- B) Është bashkësi veprimesh ciklike dhe fazike që realizohet me shpërthime të ndryshueshëm?
